



## REAGIM PUBLIK

22.06.2016

Ngjarja shokuese ku një fëmijë 3 vjeçar bie pre e dhunës fizike dhe psikologjike e personit të besuar nga prindi për kujdesin e fëmijës.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve vazhdon të theksojë funksionimin profesional, me standarte dhe përgjegjësi të institucioneve edukuese, monitoruese, vlerësuese dhe politikbërëse për të përmbushur çdo detyrim në sigurim të jetës dhe dinjitetit të çdo të mituri pavarësisht rrethanave apo të vendndodhjes së tij.

Rastet e dhunës të përsëritura mbi të cilat opinionin publik informohet, por edhe ato të cilat ndodhin përtej faktit të publikimit tregojnë se asnjë institucion edukues nuk garanton jetën dhe mirëqënien e fëmijës.

Observatori nisur nga publikimi i këtyre rasteve dhe fakteve të tjera të ditura por jo publike, u drejtohet strukturave ligjvënëse në vend të ndërhyjnë në mekanizmin referim- monitorim-vlerësim të institucioneve të parashkollorit dhe më lart. Më konkretisht apelojmë për:

1. Shtrirje të zyrave të inspektimit në çdo rajon të vendit për të intensifikuar vëzhgimet në çdo institucion edukues të fëmijëve në vend;
2. Mirëpërcaktimi i standarteve, procedurave dhe periodicitetit për misionet e inspektimit duke siguruar që ato të realizohen nga profesionistët e duhur;
3. Hartimi dhe detajimi i hapave që një institucion arsimor reagon në rastet kur prindërit raportojnë sjellje të dhunshme duke mirëpërcaktuar rolet dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit autoritet pjesë e strukturave arsimore